42	4881 - 4900	7740 - 7748	8076 - 8084	336
43	4901 - 4920	7750 - 7780	8093 - 8123	343
44	4921 - 4940	7781 - 7811	8122 - 8152	341
45	4941 - 4960	7813 - 7843	8153 - 8183	340
46	4961 - 4980	7844 - 7875	8183 - 8214	339
47	4981 - 5000	7876 - 7906	8213 - 8243	337
48	5001 - 5020	7908 - 7938	8244 - 8274	336
49	5021 - 5040	7939 - 7969	8274 - 8304	335
50	5041 - 5060	7971 - 8001	8304 - 8334	333
51	5061 - 5080	8003 - 8033	8335 - 8365	332
52	5081 - 5100	8034 - 8064	8365 - 8395	331
53	5101 - 5120	8066 - 8096	8395 - 8425	329
54	5121 - 5140	8097 - 8128	8425 - 8456	328
55	5141 - 5160	8129 - 8159	8456 - 8486	327
56	5161 - 5180	8161 - 8191	8486 - 8516	325
57	5181 - 5200	8192 - 8222	8516 - 8546	324
58	5201 - 5220	8224 - 8254	8547 - 8577	323
59	5221 - 5240	8256 - 8286	8577 - 8607	321
60	5241 - 5260	8287 - 8317	8607 - 8637	320

61	5261 - 5280	8319 - 8349	8638 - 8668	319
62	5281 - 5300	8350 - 8381	8668 - 8699	318
63	5301 - 5320	8382 - 8412	8698 - 8728	316
64	5321 - 5340	8414 - 8444	8729 - 8759	315
65	5341 - 5360	8445 - 8475	8759 - 8789	314
66	5360 - 5380	8475 - 8507	8789 - 8819	312
67	5381 - 5400	8509 - 8539	8820 - 8850	311
68	5401 - 5420	8540 - 8570	8850 - 8880	310
69	5421 - 5440	8572 - 8602	8880 - 8910	308
70	5441 - 5460	8603 - 8634	8910 - 8941	307
71	5461 - 5480	8635 - 8665	8941 - 8971	306
72	5481 - 5500	8667 - 8697	8971 - 9001	304
73	5501 - 5520	8698 - 8728	9001 - 9031	303
74	5521 - 5540	8730 - 8760	9032 - 9062	302
75	5541 - 5560	8762 - 8792	9062 - 9092	300
76	5561 - 5580	8793 - 8823	9092 - 9122	299
77	5581 - 5600	8825 - 8855	9123 - 9153	298
78	5601 - 5620	8856 - 8887	9153 - 9184	297
79	5621 - 5640	8888 - 8918	9183 - 9213	295
80	5641 - 5660	8920 - 8950	9214 - 9244	294
81	5661 - 5680	8951 - 8981	9244 - 9274	293
82	5681 - 5700	8983 - 9013	9274 - 9304	291
83	5701 - 5720	9015 - 9045	9305 - 9335	290
84	5721 - 5740	9046 - 9076	9335 - 9365	289
85	5741 - 5760	9078 - 9108	9365 - 9395	287
86	5761 - 5780	9109 - 9139	9395 - 9425	286
87	5781 - 5800	9141 - 9171	9426 - 9456	285
88	5801 - 5820	9173 - 9203	9456 - 9486	283
89	5821 - 5840	9204 - 9234	9486 - 9516	282
90	5841 - 5860	9236 - 9266	9517 - 9547	281
91	5861 - 5880	9268 - 9298	9547 - 9577	279
92	5881 - 5900	9299 - 9329	9577 - 9607	278
93	5901 - 5920	9331 - 9361	9608 - 9638	277
94	5921 - 5940	9362 - 9392	9638 - 9668	276
95	5941 - 5960	9394 - 9424	9668 - 9698	274
96	5961 - 5980	9426 - 9456	9699 - 9729	273
97	5981 - 6000	9457 - 9487	9729 - 9759	272
98	6001 - 6020	9489 - 9519	9759 - 9789	270
99	6021 - 6040	9521 - 9551	9790 - 9820	269
100	6041 - 6060	9552 - 9582	9820 - 9850	268
101	6061 - 6080	9584 - 9614	9850 - 9880	266
102	6081 - 6100	9615 - 9645	9880 - 9910	265
103	6101 - 6120	9647 - 9677	9911 - 9941	264
104	6121 - 6140	9679 - 9709	9941 - 9971	262
105	6141 - 6160	9710 - 9740	9971 - 10001	261
106	6161 - 6180	9742 - 9772	10002 - 10032	260
107	6181 - 6200	9774 - 9804	10032 - 10062	258
108	6201 - 6220	9805 - 9835	10062 - 10092	257
109	6221 - 6240	9837 - 9867	10093 - 10123	256
110	6241 - 6260	9868 - 9898	10122 - 10152	254
111	6261 - 6280	9900 - 9930	10153 - 10183	253
112	6281 - 6300	9932 - 9962	10184 - 10214	252
113	6301 - 6320	9963 - 9993	10213 - 10243	250
114	6321 - 6340	9995 - 10025	10244 - 10274	249
115	6341 - 6360	10027 - 10057	10275 - 10305	248
116	6361 - 6380	10058 - 10088	10304 - 10334	246
117	6381 - 6400	10090 - 10120	10335 - 10365	245
118	6401 - 6420	10121 - 10151	10365 - 10395	244
119	6421 - 6440	10153 - 10183	10395 - 10425	242
120	6441 - 6460	10185 - 10215	10426 - 10456	241
121	6461 - 6480	10216 - 10246	10456 - 10486	240
122	6481 - 6500	10248 - 10278	10487 - 10517	239
123	6501 - 6520	10280 - 10310	10517 - 10547	237
124	6521 - 6540	10311 - 10341	10547 - 10577	236
125	6541 - 6560	10343 - 10373	10578 - 10608	235
126	6561 - 6580	10374 - 10404	10607 - 10637	233
127	6581 - 6600	10406 - 10436	10638 - 10668	232
128	6601 - 6620	10438 - 10468	10669 - 10699	231
129	6621 - 6640	10469 - 10499	10698 - 10728	229
130	6640 - 6660	10499 - 10531	10728 - 10759	228
131	6661 - 6680	10533 - 10563	10760 - 10790	227
132	6681 - 6700	10564 - 10594	10789 - 10819	225

133	6701 - 6720	10596 - 10626	10820 - 10850	224
134	6721 - 6740	10627 - 10657	10850 - 10880	223
135	6741 - 6760	10659 - 10689	10880 - 10910	221
136	6761 - 6780	10691 - 10721	10911 - 10941	220
137	6781 - 6800	10722 - 10752	10941 - 10971	219
138	6801 - 6820	10754 - 10784	10972 - 11002	218
139	6821 - 6840	10786 - 10816	11002 - 11032	216
140	6841 - 6860	10817 - 10847	11032 - 11062	215
141	6861 - 6880	10849 - 10879	11063 - 11093	214
142	6881 - 6900	10880 - 10910	11092 - 11122	212
143	6901 - 6920	10912 - 10942	11123 - 11153	211
144	6921 - 6940	10944 - 10974	11154 - 11184	210
145	6941 - 6960	10975 - 11005	11183 - 11213	208
146	6961 - 6980	11007 - 11037	11214 - 11244	207
147	6981 - 7000	11039 - 11069	11245 - 11275	206
148	7001 - 7020	11070 - 11100	11274 - 11304	204
149	7021 - 7040	11102 - 11132	11305 - 11335	203
150	7041 - 7060	11133 - 11163	11336 - 11365	202
151	7061 - 7080	11165 - 11195	11366 - 11395	200
152	7081 - 7100	11197 - 11227	11396 - 11426	199
153	7101 - 7120	11228 - 11258	11426 - 11456	198
154	7121 - 7140	11260 - 11290	11457 - 11487	197
155	7141 - 7160	11292 - 11322	11487 - 11517	195
156	7161 - 7180	11323 - 11353	11517 - 11547	194
157	7181 - 7200	11355 - 11385	11547 - 11577	192
158	7201 - 7220	11386 - 11416	11577 - 11607	191
159	7221 - 7240	11418 - 11448	11608 - 11638	190
160	7241 - 7260	11450 - 11480	11639 - 11669	189
161	7261 - 7280	11481 - 11511	11668 - 11698	187
162	7281 - 7300	11513 - 11543	11699 - 11729	186
163	7301 - 7320	11545 - 11575	11729 - 11759	184
164	7321 - 7340	11576 - 11606	11759 - 11789	183
165	7341 - 7360	11608 - 11638	11790 - 11820	182
166	7361 - 7380	11638 - 11669	11820 - 11850	181
167	7381 - 7400	11671 - 11701	11850 - 11880	179
168	7401 - 7420	11703 - 11733	11881 - 11911	178
169	7421 - 7440	11734 - 11764	11911 - 11941	177
170	7441 - 7460	11766 - 11796	11941 - 11971	175
171	7461 - 7480	11796 - 11828	11971 - 12002	174
172	7481 - 7500	11829 - 11859	12002 - 12032	173
173	7501 - 7520	11861 - 11891	12032 - 12062	171
174	7521 - 7540	11892 - 11922	12062 - 12092	170
175	7541 - 7560	11924 - 11954	12093 - 12123	169
176	7561 - 7580	11956 - 11986	12123 - 12153	167
177	7581 - 7600	11987 - 12017	12153 - 12183	166
178	7601 - 7620	12019 - 12049	12184 - 12214	165
179	7621 - 7640	12051 - 12081	12214 - 12244	163
180	7641 - 7660	12082 - 12112	12244 - 12274	162
181	7661 - 7680	12114 - 12144	12275 - 12305	161
182	7681 - 7700	12145 - 12175	12305 - 12335	160
183	7701 - 7720	12177 - 12207	12335 - 12365	158
184	7721 - 7740	12209 - 12239	12366 - 12396	157
185	7741 - 7760	12240 - 12270	12396 - 12426	156
186	7761 - 7780	12272 - 12302	12426 - 12456	154
187	7781 - 7800	12304 - 12334	12457 - 12487	153
188	7801 - 7820	12335 - 12365	12487 - 12517	152
189	7821 - 7840	12367 - 12397	12517 - 12547	150
190	7841 - 7860	12398 - 12428	12547 - 12577	149
191	7861 - 7880	12430 - 12460	12578 - 12608	148
192	7881 - 7900	12462 - 12492	12608 - 12638	146
193	7901 - 7920	12493 - 12523	12638 - 12668	145
194	7921 - 7940	12525 - 12555	12669 - 12699	144
195	7941 - 7960	12557 - 12587	12699 - 12729	142
196	7961 - 7980	12588 - 12618	12729 - 12759	141
197	7981 - 8000	12620 - 12650	12760 - 12790	140

Tabela "Ea"

Per rritjen e diferencuar te pensioneve te invaliditetit te caktuara deri ne 30.06.1991				
Nr	Shuma e pensionit mujor me 30.06.1991	Shuma e pensionit mujor me 01.07.2003	Shuma e pensionit llogaritur sipas koeficienteve te indeksimit te pensionit minimal	Diferenca per rimbursim
1	569	9,876	9,976	100
2	570	9,876	9,987	111
3	571	9,876	9,998	122
4	572	9,876	10,009	133
5	573	9,876	10,020	145
6	574	9,876	10,032	156
7	575	9,876	10,043	167
8	576	9,876	10,054	178
9	577	9,876	10,065	189
10	578	9,876	10,076	200
11	579	9,876	10,087	211
12	580	9,876	10,098	223
13	581	9,876	10,110	234
14	582	9,876	10,121	245
15	583	9,876	10,132	256
16	584	9,876	10,143	267
17	585	9,876	10,154	278
18	586	9,876	10,165	289
19	587	9,876	10,176	300
20	588	9,876	10,187	312
21	589	9,876	10,199	323
22	590	9,876	10,210	334
23	591	9,876	10,221	345
24	592	9,876	10,232	356
25	593	9,876	10,243	367
26	594	9,876	10,254	378
27	595	9,876	10,265	390
28	596	9,876	10,277	401
29	597	9,876	10,288	412
30	598	9,876	10,299	423
31	599	9,876	10,310	434
32	600	9,876	10,321	445
33	601	9,876	10,332	456
34	602	9,876	10,343	467
35	603	9,876	10,355	479
36	604	9,876	10,366	490
37	605	9,876	10,377	501
38	606	9,876	10,388	512
39	607	9,876	10,399	523
40	608	9,876	10,410	534
41	609	9,876	10,421	545
42	610	9,876	10,432	557
43	611	9,876	10,444	568
44	612	9,876	10,455	579
45	613	9,876	10,466	590
46	614	9,876	10,477	601
47	615	9,876	10,488	612
48	616	9,876	10,499	623

49	617	9,876	10,510	635
50	618	9,876	10,522	646
51	619	9,876	10,533	657
52	620	9,876	10,544	668
53	621	9,876	10,555	679
54	622	9,876	10,566	690
55	623	9,876	10,577	701
56	624	9,876	10,588	712
57	625	9,876	10,599	724
58	626	9,876	10,611	735
59	627	9,876	10,622	746
60	628	9,876	10,633	757
61	629	9,876	10,644	768
62	630	9,876	10,655	779
63	631	9,876	10,666	790
64	632	9,876	10,677	802
65	633	9,876	10,689	813
66	634	9,876	10,700	824
67	635	9,876	10,711	835
68	636	9,876	10,722	846
69	637	9,876	10,733	857
70	638	9,876	10,744	868
71	639	9,876	10,755	880
72	640	9,876	10,767	891
73	641	9,876	10,778	902
74	642	9,876	10,789	913
75	643	9,876	10,800	924
76	644	9,876	10,811	935
77	645	9,876	10,822	946
78	646	9,876	10,833	957
79	647	9,876	10,844	969
80	648	9,876	10,856	980
81	649	9,876	10,867	991
82	650	9,876	10,878	1,002
83	651	9,876	10,889	1,013
84	652	9,876	10,900	1,024
85	653	9,876	10,911	1,035
86	654	9,876	10,922	1,047
87	655	9,876	10,934	1,058
88	656	9,876	10,945	1,069
89	657	9,876	10,956	1,080
90	658	9,876	10,967	1,091
91	659	9,876	10,978	1,102
92	660	9,876	10,989	1,113
93	661	9,876	11,000	1,124
94	662	9,876	11,012	1,136
95	663	9,876	11,023	1,147
96	664	9,876	11,034	1,158
97	665	9,876	11,045	1,169
98	666	9,876	11,056	1,180
99	667	9,876	11,067	1,191
100	668	9,876	11,078	1,202
101	669	9,876	11,089	1,214
102	670	9,876	11,101	1,225
103	671	9,876	11,112	1,236
104	672	9,876	11,123	1,247
105	673	9,876	11,134	1,258
106	674	9,876	11,145	1,269
107	675	9,876	11,156	1,280
108	676	9,876	11,167	1,292
109	677	9,876	11,179	1,303
110	678	9,876	11,190	1,314

111	679	9,876	11,201	1,325
112	680	9,876	11,212	1,336
113	681	9,876	11,223	1,347
114	682	9,876	11,234	1,358
115	683	9,876	11,245	1,369
116	684	9,876	11,256	1,381
117	685	9,876	11,268	1,392
118	686	9,876	11,279	1,403
119	687	9,876	11,290	1,414
120	688	9,876	11,301	1,425
121	689	9,876	11,312	1,436
122	690	9,876	11,323	1,447
123	691	9,876	11,334	1,459
124	692	9,876	11,346	1,470
125	693	9,876	11,357	1,481
126	694	9,876	11,368	1,492
127	695	9,876	11,379	1,503
128	696	9,876	11,390	1,514
129	697	9,876	11,401	1,525
130	698	9,876	11,412	1,537
131	699	9,876	11,424	1,548
132	700	9,876	11,435	1,559

Tabela "Eb"

Per rritjen e diferencuar te pensioneve te invaliditetit te caktuara ne periudhen 01.07.1991 - 30.09.1993				
Nr	Interval I shumes mujore te pensionit me 30.09.1993	Interval I shumes mujore te pensionit 01.07.2003	Interval I shumes se pensionit logaritme sipas koeficienteve te indeksimit te pensionit minimal	Diferenca per rimbursim
1	1456 - 1465	7467 - 7500	7572 - 7605	105
2	1466 - 1475	7504 - 7537	7638 - 7671	134
3	1476 - 1485	7541 - 7574	7704 - 7737	163
4	1486 - 1495	7578 - 7611	7770 - 7803	192
5	1496 - 1505	7615 - 7649	7836 - 7870	221
6	1506 - 1515	7652 - 7686	7902 - 7936	250
7	1516 - 1525	7689 - 7723	7968 - 8002	279
8	1526 - 1535	7726 - 7760	8035 - 8069	309
9	1536 - 1545	7763 - 7797	8101 - 8135	338
10	1546 - 1555	7800 - 7834	8167 - 8201	367
11	1556 - 1565	7837 - 7871	8233 - 8267	396
12	1566 - 1575	7874 - 7908	8299 - 8333	425
13	1576 - 1585	7912 - 7945	8366 - 8399	454
14	1586 - 1595	7949 - 7982	8432 - 8465	483
15	1596 - 1605	7986 - 8019	8498 - 8531	512
16	1606 - 1615	8023 - 8056	8564 - 8597	541
17	1616 - 1625	8060 - 8093	8631 - 8664	571
18	1626 - 1635	8097 - 8130	8697 - 8730	600
19	1636 - 1645	8134 - 8167	8763 - 8796	629
20	1646 - 1655	8171 - 8204	8829 - 8862	658
21	1656 - 1665	8208 - 8241	8895 - 8928	687
22	1666 - 1675	8245 - 8278	8961 - 8994	716
23	1676 - 1685	8282 - 8315	9027 - 9060	745
24	1686 - 1695	8319 - 8352	9093 - 9126	774
25	1696 - 1705	8356 - 8389	9159 - 9192	803
26	1706 - 1715	8393 - 8426	9225 - 9258	832
27	1716 - 1725	8430 - 8463	9292 - 9325	862
28	1726 - 1735	8467 - 8500	9358 - 9391	891
29	1736 - 1745	8504 - 8537	9424 - 9457	920
30	1746 - 1755	8541 - 8574	9490 - 9523	949
31	1756 - 1765	8578 - 8612	9556 - 9590	978
32	1766 - 1775	8615 - 8649	9622 - 9656	1,007
33	1776 - 1785	8652 - 8686	9688 - 9722	1,036
34	1786 - 1795	8689 - 8723	9754 - 9788	1,065
35	1796 - 1805	8726 - 8760	9821 - 9855	1,095
36	1806 - 1815	8763 - 8797	9887 - 9921	1,124
37	1816 - 1825	8800 - 8834	9953 - 9987	1,153
38	1826 - 1835	8837 - 8871	10019 - 10053	1,182
39	1836 - 1845	8875 - 8908	10086 - 10119	1,211
40	1846 - 1855	8912 - 8945	10152 - 10185	1,240
41	1856 - 1865	8949 - 8982	10218 - 10251	1,269
42	1866 - 1875	8986 - 9019	10284 - 10317	1,298
43	1876 - 1885	9023 - 9056	10350 - 10383	1,327
44	1886 - 1895	9060 - 9093	10417 - 10450	1,357
45	1896 - 1905	9097 - 9130	10483 - 10516	1,386
46	1906 - 1915	9134 - 9167	10549 - 10582	1,415
47	1916 - 1925	9171 - 9204	10615 - 10648	1,444
48	1926 - 1935	9208 - 9241	10681 - 10714	1,473
49	1936 - 1945	9245 - 9278	10747 - 10780	1,502
50	1946 - 1955	9282 - 9315	10813 - 10846	1,531
51	1956 - 1965	9319 - 9352	10879 - 10912	1,560
52	1966 - 1975	9356 - 9389	10945 - 10978	1,589
53	1976 - 1985	9393 - 9426	11011 - 11044	1,618
54	1986 - 1995	9430 - 9463	11078 - 11111	1,648
55	1996 - 2005	9467 - 9500	11144 - 11177	1,677
56	2006 - 2015	9504 - 9538	11210 - 11244	1,706
57	2016 - 2025	9541 - 9575	11276 - 11310	1,735
58	2026 - 2035	9578 - 9612	11342 - 11376	1,764
59	2036 - 2042	9615 - 9638	11404 - 11427	1,789

VENDIM
Nr.788, datë 26.11.2003

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.426, DATË 9.7.1998 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE "PËR PËRBALLIMIN E SHPENZIMEVE TË SHËRBIMIT TË VARRIMIT
PËR SHTETASIT SHQIPTARË, QË VDESIN BREDA DHE JASHTË SHTETIT"

Në mbështetje të pikës 2 të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2 të nenit 55 të ligjit nr.8950, datë 10.10.2002 "Për gjendjen civile", me propozimin e Ministrit të Rregullimit të Territorit dhe të Turizmit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr.426, datë 9.7.1998 të Këshillit të Ministrave të bëhen këto ndryshime:

1. Pika 3 ndryshohet si më poshtë vijon:

"3. Ministria e Rregullimit të Territorit dhe e Turizmit, me fonde të Buxhetit të Shtetit, organizon shërbimin e transportit të kufomave dhe të eshtrave vetëm për rastet e fatkeqësive të ndodhura jashtë territorit të vendit, për personat që janë dërguar me shërbim ose mjekim shëndetësor nga shteti, për punonjësit e përfaqësive diplomatike, si dhe për rastet e veçanta, sipas kërkesës së bërë nga institucione, njësi të qeverisjes vendore apo shoqata të ndryshme.

Për shtetasit shqiptarë, që vdesin jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, kur shpenzimet e transportit përballohen nga familjarët e të ndjerit, Buxheti i Shtetit rimbursen një pjesë të këtyre shpenzimeve.

Rastet e veçanta dhe masa e kontributit të shtetit në përballimin e shpenzimeve të varrimit përcaktohen me udhëzim të përbashkët të Ministrit të Rregullimit të Territorit dhe të Turizmit dhe të Ministrit të Financave."

2. Në të gjithë vendimin emërtimi "Ministria e Punëve Publike dhe Transportit", zëvendësohet me "Ministria e Rregullimit të Territorit dhe e Turizmit" dhe emërtimi "Këshilli i rrethit" zëvendësohet me "Qark".

3. Ngarkohen Ministria e Rregullimit të Territorit dhe e Turizmit dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

VENDIM
Nr.789, datë 26.11.2003

PËR FUNKSIONIMIN DHE ORGANIZIMIN E KËSHILLIT TË ZHVILLIMIT TË
TURIZMIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 4 të ligjit nr.7665, datë 21.1.1993 "Për zhvillimin e zonave që kanë përparësi turizmin", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Rregullimit të Territorit dhe të Turizmit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Këshilli i Zhvillimit të Turizmit, si organ ndërmënytor, të kryesohet nga Ministri i Rregullimit të Territorit dhe i Turizmit dhe në përbërje të ketë:

-1 përfaqësues nga kabineti i Kryeministrit
-4 përfaqësues nga Ministria e Rregullimit të

anëtar;

- | | |
|--|----------|
| Territorit dhe e Turizmit | anëtarë; |
| -1 përfaqësues nga Ministria e Financave | anëtar; |
| -1 përfaqësues nga Ministria e Bujqësisë dhe e Ushqimit | anëtar; |
| -1 përfaqësues nga Ministria e Mjedisit | anëtar; |
| -1 përfaqësues nga Ministria e Kulturës,
Rinisë dhe Sporteve | anëtar; |
| -1 përfaqësues nga Ministria e Pushtetit Vendor
dhe e Decentralizimit | anëtar. |
2. Funksionimi dhe organizimi i brendshëm i këtij Këshilli përcaktohet në rregulloren që i bashkëlidhet këtij vendimi.
3. Anëtarët e Këshillit të Zhvillimit të Turizmit të shpërblehen për pjesëmarrjen e tyre, për çdo mbledhje, në masën 15 000 (pesëmbëdhjetë mijë) lekë, por jo më shumë se 1 herë në muaj.
4. Fondet për shpërblimin e anëtarëve të Këshillit të Zhvillimit të Turizmit të përballohen nga buxhetet e miratuara për çdo institucion përkatës, që ata përfaqësojnë.
5. Vendimi nr.340, datë 11.7.2002 i Këshillit të Ministrave "Për përbërjen, funksionet, detyrat, përgjegjësitë dhe organizimin e brendshëm të Këshillit të Zhvillimit të Turizmit", shfuqizohet.
6. Ngarkohet Ministria e Rregullimit të Territorit dhe e Turizmit për zbatimin e këtij vendimi. Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

RREGULLORE

PËR FUNKSIONIMIN DHE ORGANIZIMIN E KËSHILLIT TË ZHVILLIMIT TË TURIZMIT

Neni 1 **Objekti**

Kjo Rregullore përcakton organizimin dhe funksionimin e Këshillit për Zhvillimin e Turizmit si organ ndërmënyës, që krijohet dhe kryen detyrat në zbatim të ligjit nr.7665, datë 21.1.1993 "Për zhvillimin e zonave që kanë përparësi turizmin", me ndryshimet përkatëse.

Neni 2 **Organizimi**

Këshilli i Zhvillimit të Turizmit (KZHT) mbledhet nga Ministri i Rregullimit të Territorit dhe të Turizmit, i cili përcakton axhendën e mbledhjes dhe kryesohet prej tij. Në rastet kur mbledhja është e domosdoshme të zhvillohet ditën e caktuar dhe kryetari e ka të pamundur drejtimin e mbledhjes, ai cakton një nga anëtarët e Këshillit të Zhvillimit të Turizmit. Njoftimi për mbledhjen bëhet të paktën 3 ditë përpara datës së zhvillimit të mbledhjes.

Neni 3 **Funksionimi**

Këshilli i zhvillon mbledhjet kur janë të pranishëm shumica e anëtarëve të tij, pra jo më pak se pesë veta. Në rastet kur pjesëmarrja nuk sigurohet si më sipër, mbledhja e Këshillit do të bëhet jo më vonë se dy javë nga data e njoftimit të ri. Në raste të veçanta, me propozim të kryetarit të tij, Këshilli mund të mbledhet në mbledhje jashtë radhe. Kur gjykohet e nevojshme, Këshilli mund të zhvillojë mbledhjen e tij në qendrën respektive të rrethit ku bën pjesë zona që do të jetë objekt i diskutimit. Këshilli shqyrton kërkesat, jo më vonë se dy muaj nga data e paraqitjes së kërkesës.

Neni 4 **Vendimarrja**

Këshilli i Zhvillimit të Turizmit vendos me shumicë votash. Në rastet kur numri i votave është ndarë në mënyrë të barabartë, vendos vota e kryetarit të Këshillit. Në mbledhjen e Këshillit të Zhvillimit të Turizmit, sipas objektit të çështjes, mund të thirren specialistë ekspertë, të cilët marrin pjesë në mbledhje pa të drejtë vote.

Neni 5

Detyrat e sekretarisë së KZHT-së

Funksionin e sekretarisë së KZHT-së e kryen struktura që mbulon zhvillimin e turizmit në Ministrinë e Rregullimit të Territorit dhe të Turizmit.

Sekretaria e KZHT-së ka këto detyra:

- realizon publikimin e masterplaneve dhe të studimeve urbanistike të zonave turistike dhe dërgimin zyrtar të tyre pranë njësive të qeverisjes vendore;
- organizon mbledhjen dhe përgatit materialet që do të shqyrtohen në mbledhjen e Këshillit të Zhvillimit të Turizmit;
- harton vendimin në bazë të procesverbalit të mbledhjes së Këshillit.

Sekretaria përgatit dosjen-kërkesë, pas plotësimit të dokumentacionit ligjor dhe teknik nga subjekti person fizik ose juridik, që kërkon të fitojë titullin "person i stimuluar".

Neni 6

Administrimi i dokumentacionit

Brenda strukturës që mbulon zhvillimin e turizmit, një punonjës caktohet sekretar i sekretarisë së KZHT-së dhe ka për detyrë:

- të kryejë të gjithë anën protokollare dhe të administrojë dosje-kërkesat e personave fizikë e juridikë, që ka shqyrtuar ose do të shqyrtojë Këshilli;
- të njoftojë anëtarët e Këshillit për datën, orën dhe rendin e ditës së mbledhjes së Këshillit, merr konfirmimet rreth pjesëmarrjes dhe vë në dijeni kryetarin;
- të njoftojë personat fizikë dhe juridikë, rreth vendimit të Këshillit, lidhur me kërkesat e tyre;
- të sistemojë në dosjet përkatëse vendimet përfundimtare.

Neni 7

Paraqitja e kërkesës

Çdo person fizik dhe juridik ka të drejtën të paraqesë kërkesën për të zhvilluar ose vazhduar veprimtarinë e stimuluar, si dhe për marrjen e titullit person i stimuluar pranë strukturës që mbulon zhvillimin e turizmit në Ministrinë e Rregullimit të Territorit dhe të Turizmit, që njëkohësisht kryen edhe funksionin e sekretarisë në Këshillin e Zhvillimit të Turizmit.

Neni 8

Plotësimi i dokumentacionit ligjor dhe teknik

I. Dokumentacioni që duhet të paraqesë subjekti, person juridik, për të zhvilluar ose vazhduar veprimtari të stimuluar, si dhe për marrjen e titullit "person i stimuluar" është si më poshtë:

1. Formulari nr.1 i plotësuar me të gjitha seksionet përbërëse, sipas modelit që i bashkëlidhet kësaj rregulloreje.
2. Vendimi për regjistrimin në gjykatë si person juridik, statuti dhe akti i themelimit.
3. Dokumenti nga banka, ku të konfirmohet se investimi që do të kryejë subjekti mbulohet me shumën e depozituar pranë saj.
4. Të dhënat financiare nëpërmjet bilancit të shoqërisë, të konfirmuar nga organet tatimore.
5. Analizë prefizibiliteti (e cila presupozon analizën ekonomike, financiare, ambientale, sociale, në mënyrë të përgjithshme, me qëllimin e paraqitjes së një treguesi mbi mundshmërinë e realizimit të projektit të propozuar).
6. Relacioni përshkrues i projektit.
7. Studimi urbanistik për zonën në interes.
8. Vërtetimi i titullit të pronësisë, për tokën-truall, mbi të cilën do të zhvillohet investimi,

marrë nga zyrat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme. Dokumenti duhet të jetë original dhe të mbajë datën jo më parë se 3 muaj nga data e depozitimit të kërkesës.

9. Paraqitja grafike e propozuar në nivelin e projektidesë.

10. Dëftesa e derdhjes së shumës së garancisë.

11. Derdhja e "shpenzimit administrativ", të pakthyesëm prej 100 USD, në llogarinë e Ministrisë së Rregullimit të Territorit dhe të Turizmit.

II. Dokumentacioni që duhet të paraqesë subjekti, person fizik, për të zhvilluar ose vazhduar veprimtari të stimuluar, si dhe për marrjen e titullit "person i stimuluar" është si më poshtë:

1. Formulari nr.1 i plotësuar me të gjitha seksionet përbërëse, sipas modelit që i bashkëlidhet kësaj rregulloreje.

2. Vendimi për regjistrimin në gjykatë si person fizik.

3. Dokumenti nga banka, ku të konfirmohet se investimi që do të kryejë subjekti mbulohet me shumën e depozituar pranë saj.

4. Të gjitha kërkesat e mësipërme, duke filluar nga pika 5 deri në pikën 11.

III. Dokumentacioni që duhet të paraqesë subjekti, person fizik ose juridik, për veprimtari jo turistike në zonë të stimuluar është si më poshtë:

1. Kërkesa me të dhëna për aplikantin (person fizik ose juridik) dhe mbi tipin e veprimtarisë që do të zhvillohet.

2. Relacioni përshkrues i kriterëve të projektimit.

3. Studimi urbanistik për zonën në interes.

4. Vërtetimi i titullit të pronësisë, për tokën-trull, mbi të cilin do të zhvillohet investimi, marrë nga organi kompetent.

5. Projekti i propozuar në nivelin e projektidesë.

6. Derdhja e "shpenzimit administrativ", të pakthyesëm prej 100 USD, në llogarinë e Ministrisë së Rregullimit të Territorit dhe të Turizmit.

Neni 9

Njoftimi i subjektit kërkuar

Kur kërkesa është e plotë, sekretaria njofton kërkuarësin për pagesën e depozitës sipas kriterëve të përcaktuara në nenin 7 të ligjit nr.7665, datë 21.1.1993 "Për zhvillimin e zonave që kanë përparësi turizmin".

Shuma depozitohet nga personi fizik ose juridik në një llogari rrjedhëse, në një bankë të caktuar nga Ministria e Rregullimit të Territorit dhe e Turizmit. Kur formulari shoqërohet me pagesën e depozitës së përmendur më sipër, data e paraqitjes së konfirmimit bankar do të jetë dhe data e paraqitjes së kërkesës nga subjekti.

Neni 10

Mbi vënien në dispozicion të shesheve të ndërtimit

Në bazë të ligjit nr.7665, datë 21.1.1993 "Për zhvillimin e zonave që kanë përparësi turizmin", neni 4 shkronja a, nëpërmjet sekretarisë, Këshilli kërkon nga organet qendrore ose lokale, vënien në dispozicion të tij të shesheve të ndërtimit për struktura turistike në zona të stimuluar ose ato urbane, së bashku me studimet urbanistike, të miratuara sipas dispozitave në fuqi, kondicionet urbanistike, teknike etj., si dhe çdo element tjetër të nevojshëm për një shesh ndërtimi, që do të zhvillohet nga kërkuarësi.

KZHT-ja bën miratimin e kërkesave për zhvillimin e shesheve të ndërtimit, duke u mbështetur në kriteret e vlerësimit për zhvillimin e projektit turistik, sipas formularit nr.2, që i bashkëlidhet kësaj rregulloreje. Përcaktimi i këtyre kriterëve lehtëson dhe bën të mundur përzgjedhjen e ofertës më të leverdisshme ndërmjet konkurrentëve.

Neni 11

Dhënia e vendimit të KZHT-së

Pas shqyrtimit nga Këshilli të kërkesave për dhënien e lejes për veprimtari të stimuluar ose për vazhdimin e saj, ndiqet procedura që vijon:

- Këshilli bën të njohur vendimin paraprak, lidhur me kërkesën dhe pala e interesuar ka të drejtë t'i paraqesë Këshillit, brenda 90 ditëve, propozimet ose kundërshtimet për këtë vendim.
- Këshilli vendos përfundimisht brenda 60 ditëve, nga data e paraqitjes së propozimeve ose kundërshtimeve.

Neni 12

Lidhja e marrëveshjeve

Në mbështetje të nenit 7, 8, 9, 10 të ligjit nr.7665, datë 21.1.1993, Këshilli, nëpërmjet sekretarisë, organizon lidhjen e marrëveshjeve të qirasë dhe zhvillimit (sipas titullit të pronësisë) sipas marrëveshjeve tip të miratuara nga Ministri i Rregullimit të Territorit dhe të Turizmit, ndërmjet personit fizik ose juridik, të stimuluar dhe Ministrisë. Veprimtaria e stimuluar fillon në datën e përcaktuar në marrëveshjen e zhvillimit.

Personi fizik ose juridik, me marrjen e së drejtës për të zhvilluar veprimtari të stimuluar, brenda afateve të përcaktuara në ligjin nr.7665, datë 21.1.1993, neni 7 shkronja "a", (jo më vonë se 12 muaj nga koha e dhënies të së drejtës), duhet të përgatisë projektin teknik/ose studimin e nevojshëm dhe atë ekonomiko-financiar.

Neni 13

Dokumentacioni për lidhjen e marrëveshjeve

Dokumentacioni që duhet të paraqesë subjekti, i cili ka fituar titullin "person i stimuluar", për lidhjen e marrëveshjes së qirasë dhe të zhvillimit është si më poshtë:

1. Programin e investimeve:
 - buxhetin e detajuar të ndërtimit dhe të zhvillimit të projektit;
 - parashikimet financiare 6-vjeçare;
 - paketën e sigurimit të investimit.
2. Plani financimit:
 - strukturën e fondeve;
 - strukturën dhe mënyrën e menaxhimit të veprimtarisë turistike.
3. Leja e ndërtimit, shoqëruar me projektin e miratuar nga organet përkatëse.

Neni 14

Mbi fillimin e veprimtarisë së stimuluar

Këshilli, nëpërmjet sekretarisë, kontrollon dhe verifikon fillimin e veprimtarisë së stimuluar nga personi i stimuluar brenda afatit të përcaktuar në marrëveshjen e zhvillimit.

Sekretaria informon në kohë Këshillin rreth zbatimit të vendimeve të tij. Në veçanti, ajo informon për çdo vonesë në afatin e marrëveshjes (pagesa, projekte etj), në mënyrën që Këshilli të ketë mundësi të vendosë rreth çështjes, si dhe për ndonjë pengesë që mund t'i dalë kërkuarit me autoritetet vendore, me qëllimin që Këshilli të ndërmarrë hapat për të siguruar vazhdimin sipas projektit të miratuar.

Neni 15

Subjekti i cili ka fituar titullin "Person i stimuluar", gjatë ushtrimit të veprimtarisë së stimuluar në zonën turistike, duhet të zbatojë dispozitat e parashikuara në ligjin nr.7665, datë 21.1.1993 "Për zhvillimin e zonave që kanë përparsi turizmin", me ndryshimet përkatëse, dispozitat e kësaj rregulloreje dhe kushtet e përgjithshme të marrëveshjeve tip të zhvillimit dhe të qirasë të miratuara me urdhër të Ministrit të Rregullimit të Territorit dhe të Turizmit.

FORMULARI NR.1

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E RREGULLIMIT TË TERRITORIT DHE E TURIZMIT

SEKSIONI 1
KËRKESA PËR KRYERJEN E NJË VEPRIMTARIE NË NJË ZONË PËR ZHVILLIMIN E
TURIZMIT NGA PERSONA FIZIKË

PERSONI FIZIK:

1.1. EMRI I PLOTË

—

1.2. KOMBËSIA

—

1.3. ADRESA E BANIMIT

—

1.4. ADRESA E PUNËS

—

1.5. REKOMANDIMET BANKARE

—

1.6. EKSPERIENCA E MËPARSHME NË FUSHËN E TURIZMIT

—

SEKSIONI 2
KËRKESË PËR KRYERJEN E NJË VEPRIMTARIE NË NJË ZONË PËR ZHVILLIMIN E
TURIZMIT NGA PERSONA JURIDIKË

PERSON JURIDIK:

2.1. EMRI PLOTË I SHOQËRISË

—

2.2. NR. I RREGJISTRIMIT SI PERSON JURIDIK

—

2.3. PËRFAQËSUES LIGJOR TË SHOQËRISË

—

2.4. SELIA E SHOQËRISË, ADRESA DHE TË DHËNAT PËRKATËSE

—

—

2.5. PRONËSIA DHE KONTROLLI

—

—

—

2.6. KAPITALI

—

—

—

2.7. REKOMANDIMET BANKARE

—

—

2.8. TË DHËNAT EKONOMIKE DHE FINANCIARE (FITIMI DHE HUMBIA; FLETA E BILANCIT); JEPNI DOKUMENTET PËRKATËSE (në qoftë se keni)

—

—

2.9. VEPRIMTARITË KRYESORE TË KANDIDATIT; EKSPERIENCA E MËPARSHME NË INDUSTRIJË E TURIZMIT

—

—

SEKSIONI 3 VEPRIMTARIA E STIMULUAR QË DO TË KRYEJË SUBJEKTI

3.1. TIPI I VEPRIMTARISË (bëhet fjala për një ose më shumë kategori të listuara)

—

—

—

—

3.2. NEVOJA PËR VEPRIMTARI (bëni një studim paraprak fizibiliteti; jepni dokumente, në qoftë se është e përshtatshme)

—

—

3.3. ZBATIMI

3.3.2. OPERIMI (përshkruani si veprimtaria e stimuluar do të prodhojë të ardhura dhe cilat do të ngarkohet me këtë detyrë: në qoftë se njësisia s'është kandidati, të sigurohet përsa i përket

rit, informacioni i kërkuar në pikat 3.1 dhe 3.2 më sipër)

SEKSIONI 4

LOKALIZIMI

4.1. IDENTIFIKIMI I SHESHIT (bashkëlidh hartën)
Qarku _____

BASHKIA _____
KOMUNA _____
ESHATI _____

FSHATI _____

4.2. SIPËRFAQIA E KËRKUAR (specifikoni sipërfaqen totale të nevojshme për projektin)

4.2. SIPËRFAQJA E KËRKËSAR (specifikimi sipërfaqsh total të nevojshme për projektin dhe sipërfaqja e kërkuar nga të gjithë kërkuarët)

Sipërfaqja e ndërtimit _____

4.3. INFRASTRUKTURAT (specifikoni infrastrukturën dhe shërbimet komunale kërkuar nga projekti). Bëni të ditur gjithashtu se si projekti do të zgjidhë çështje të tilla mund që infrastruktura dhe shërbimet të jenë në gjendje të përdoren për projektin.

net komunale të jenë të pamjaftueshme.)

4.4. SHFRYTËZIMI I TANISHËM I SHESHIT

—

—

—

4.4. NDIKIMI I MUNDSHËM I PROJEKTIT MBI AMBIENTIN

—

—

4.5. KRITERET E PROJEKTIMIT DHE NDËRTIMIT (Jepni dokumentet përkatëse, siç janë planet e sheshit dhe vizatimet fillestare arkitektonike.)

—

—

SEKSIONI 5 INVESTIMI

5.1.KOSTOJA E PROJEKTIT

Shpenzimet paraprake _____

Ndërtimi dhe pajisja _____

Buxheti total _____

5.2. Struktura e financimit

Kandidati _____

Huaja _____

Financimi total _____

5.3. KOHA E REALIZIMIT TË PROJEKTIT

—

—

5.4. PROJEKTI FINANCIAR

5.4.1. PERIUDHA E ZHVILLIMIT

Viti

Burimet e mjeteve financiare

- Ekuiteti

- Borxhi

Burimet totale

Përdorimi i mjeteve financiare

- shërbimet teknike dhe urbanistike
- kostoja e zhvillimit
- parashfrytëzimi
- kapitali qarkullues
- ndërtimi
- mobilimi dhe pajisja
- infrastruktura
- shërbimet komunale
- kosto financimit
- shpenzimi total

5.5. NDIKIMI I ZHVILLIMIT

5.5.1 PËRFITIMET E EKONOMISË VENDASE DHE PUNËSIMI (duke përfshirë edhe programin e përgatitjes.)

5.5.2. PËRDORIMI DHE SHFRYTËZIMI I PRODUKTEVE DHE SHËRBIMEVE TË VENDIT

DATA DHE FIRMA

(Jepni dëshmi që ju jeni autorizuar nga kandidati të nënshkruani këtë formular.)

FORMULARI NR.2

KRITERET E VLERËSIMIT TË NJË PROJEKTI PËR ZHVILLIM TURISTIK

Emërtimi	Ralizimi në projekt	Vlerësimi
Koef. i shfrytëzimit të territorit %		
Numri i shtresave për ha (për fshat turistik)		
Lartësia max. e ndërtimit		
Mënyra e paraqitjes së projektit		
Vlera totale e investimit		
Investimi për shtrat		
Bilanci i shoqërisë, dokumentacioni i shlyerjes së detyrimeve ndaj shtetit		
Garancia bankare nëpërmjet paraqitjes së një certifikate bankare		
Marrëveshje e menaxhimit (paraprake)		

- 1-2-3 (plotësohen kriteret, normale, jo i klasifikuar)
1- Plotësohen të gjitha kriteret
2- Plotësohen 2/3
3- Nuk plotësohen

VENDIM
Nr.790, datë 26.11.2003

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.596, DATË 28.8.2003 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE "PËR MIRATIMIN E KUOTËS SË PRANIMIT TË STUDENTËVE NË
AKADEMINË E POLICISË "ARBEN ZYLYFTARI" PËR VITIN AKADEMIK 2003-2004"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 31 të ligjit nr.8461, datë 25.2.1999 "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e Ministrit të Rendit Publik, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në pikën 1 të vendimit nr.596, datë 28.8.2003 të Këshillit të Ministrave, numri 50 (pesëdhjetë) ndryshohet dhe bëhet 65 (gjashtëdhjetë e pesë).

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

VENDIM
Nr.792, datë 26.11.2003

PËR PËRDORIMIN E FONDEVE TË ISH-FONDACIONEVE PËR NDËRTIMIN E
APARTAMENTEVE PËR KREDITORËT QË KANË HUMBUR BANESAT NGA RËNIA E
SKEMAVE PIRAMIDALE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 7/8 të ligjit nr.8215, datë 9.5.1997 "Për kontrollin financiar të personave juridikë, jobankarë, që kanë marrë hua nga publiku i gjerë", i ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Rregullimit të Territorit dhe të Turizmit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Fondet financiare prej 240 000 000 (dyqind e dyzet milionë) lekësh, gjendje në llogaritë e ish-fondacioneve bamirëse në administrim, në Bankën Kombëtare Tregtare dhe Bankën e Kursimeve, Tiranë, të transferohen në një llogari të veçantë "Fonde për ndërtimin e apartamenteve për kreditorët e skemave piramidale" për Entin Kombëtar të Banesave.

2. Fondet financiare, të përcaktuara në pikën 1 të këtij vendimi, për Entin Kombëtar të Banesave, për ndërtimin e apartamenteve për kreditorët të cilët humbën banesat nga rënia e skemave piramidale, të përdoren si më poshtë vijon:

- 160 000 000 (njëqind e gjashtëdhjetë milionë) lekë nga Bashkia e Tiranës;
- 80 000 000 (tetëdhjetë milionë) lekë nga Bashkia e Vlorës.

3. Në Bashkinë e Tiranës, ndërtimi i apartamenteve të banimit për kreditorët, me fondet e mësipërme, të fillojë me 3 godinat në ndërtim në zonën e Laprakës, Tiranë, sipas projektit të miratuar për ndërtim banesash publike, ndërsa në Bashkinë e Vlorës të fillojë me përgatitjen dhe fillimin e punimeve të ndërtimit për ngritjen e godinave në objektin ish-frigoriferi, Vlorë.

4. Sipërfaqet e trojeve për ndërtimin e apartamenteve të banimit për kreditorët që humbën banesat nga rënia e skemave piramidale, me fondin e kredisë greke për strehim dhe me fondet e planifikuara nga Buxheti i Shtetit në Laprakë, Tiranë dhe në ish-frigoriferin, Vlorë, të vihen në administrim të Entit Kombëtar të Banesave për vazhdimin e ndërtimit të apartamenteve për këta kreditorë.

5. Familjet e pastreha, që kanë humbur banesat nga rënia e skemave piramidale, përfitojnë apartamente banimi, të ndërtuara nga Enti Kombëtar i Banesave, në përputhje me vendimet e këshillave bashkiakë të Tiranës dhe të Vlorës, sipas listave parësore dhe emergjente që këto këshilla paraqesin në Entin Kombëtar të Banesave, në zbatim të rregullave dhe kritereve të përcaktuara në vendimin nr.321, datë 5.7.1999 të Këshillit të Ministrave, i ndryshuar.

6. Të ardhurat e siguruara nga këstet e derdhura të familjeve të pastreha, të përcaktuara në kontratën e shitblerjes së apartamenteve, të lidhur ndërmjet Entit Kombëtar të Banesave dhe kryefamiljarit, të riderdhen në llogarinë "Fonde për ndërtimin e apartamenteve për kreditorët e skemave piramidale" dhe të përdoren për vazhdimin e ndërtimit të apartamenteve për këta kreditorë.

7. Enti Kombëtar i Banesave të kryejë procedurat e prokurimit publik, brenda tremujorit të parë të vitit 2004.

8. Ngarkohen Ministria e Rregullimit të Territorit dhe e Turizmit, Ministria e Financave, Grupi Mbikëqyrës dhe Enti Kombëtar i Banesave për nxjerrjen e udhëzimeve për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

Fletorja Zyrtare gjendet:

- në çdo njësi postare të çdo qyteti;
 - pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare:
- Rr. Qemal Stafa, pranë ndërtesës së Prokurorisë së Përgjithshme.

Pranë **Qendrës së Publikimeve Zyrtare** mund të gjeni:

LISTA E BOTIMEVE TË AZHURNUARA DERI TETOR 2003

1.	KUSHTETUTA	600
2.	PËRMBLEDHËSE NË FUSHËN E PROKURIMIT PUBLIK	1000
3.	KODI I PROCEDURËS CIVILE	500
4.	KODI I PROCEDURËS PENALE	600
5.	KODI PENAL	400
6.	KODI I PUNËS	500
7.	KODI I FAMILJES	450
8.	KODI CIVIL	1000
9.	KODI RRUGOR	900
10.	KODI ZGJEDHOR	355
11.	PËRMBLEDHËSE E LEGJISLACIONIT NË FUSHËN E PËRMBARIMIT	800
12.	DISPOZITA ZBATUESE TË KODIT DOGANOR	1500
13.	DISPOZITA ZBATUESE TË KODIT RRUGOR	1500

Doli nga shtypi më 5.12.2003

Tirazhi: 4300 copë	Formati: 60x88/8
--------------------	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2003

Çmimi: 150 lekë